

VENDIM
Nr. 253, datë 21.12.2021

**MBI ÇMIMIN VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË DO T'U
PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM-së) nr. 687, datë 22.11.2017, “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, të ndryshuar me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 156/9 prot., datë 17.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2022”,

konstatoi se:

Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, ka miratuar “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, të rishikuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 13.5.2020, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi””.

- Nga të dhënat paraprake nga faqja e internetit të Bursës Hungareze të Energjisë, çmimi mesatar për periudhën janar–nëntor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) për vitin 2021, rezulton në vlerën 101.40 euro/mwh.

- Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit, për periudhën janar–nëntor rezulton se kursi mesatar i këmbimit të jetë 122.61 lekë/euro.

- Nga përlllogaritjet mbi të dhënat paraprake rezulton se çmimi vjetor i blerjes do të jetë:

$$P_u = 101.4 / 1000 * 1.2 * 122.61 = 14.92 \text{ lekë/kwh}$$

- Kufijtë minimalë dhe maksimalë të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, përcaktohen sipas germave “ç” dhe “d”, të pikës 2 të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, të ndryshuar, ku kufiri minimal është çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues (çmim dysHEME) dhe ai maksimal është 15% më i lartë se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues (çmim tavan).

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 13, datë 16.2.2016, ka vendosur që tarifa fikse e energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016, do të jetë 7.448 lekë/kw.

- Bazuar në përlllogaritjet mbi të dhënat paraprake, gjendemi në kushtet kur çmimi maksimal i lejuar mbështetur në përcaktimet e VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, të ndryshuar, është 15% më i lartë se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues:

$$7.448 * (1 + 15\%) = 8.5652 \text{ lekë/kwh}$$

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2022, të jetë 8.5652 lekë/kwh.

2. Me publikimin e raportit vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2021, si dhe publikimin e raportit vjetor të tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të Bursës Hungareze të Energjisë, në rast se do të ketë ndryshime që do të çojnë në ndryshimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë, ERE do të korrigjojë çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, i cili do t'u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2022.

3. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti